

Shtojca 2**Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore**


APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	“Sowi Kosovo” L.L.C.
	Vendi	Prishtinë
	Adresa	Bekim Fehmiu, ICON TOWER K.11, Nr.110, Prishtinë, Kosovë
	Nr. i tel./fax	+38344168830 +38344126465; +38349707089
	E-mail	info.selaci@gmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810850249, 01/07/2015
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Domenico Catalano
	Nr. i tel./fax	
	E-mail	domenicocatalano@enlightenergy.com
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Hana Zeka
	Nr. i tel./fax	+38349707089
	E-mail	hana.zeka@ozon-space.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	Parku i energjisë së erës “SELAC 1”


1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Fshati Selac, Komuna e Mitrovicës

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT		
2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Lokacioni ku është i instaluar parku i erës është i njohur me emrin ‘Bajgora’; vendbanimet më të afërta me zonën e projektit janë fshatrat sikurse Bajgora në Jug, Zhitia në Verilindje, Kaqandolli në Lindje dhe Zaberrxha në perëndim. Parku i erës është i vendosur në zonë të largët dhe të pabanuar, në lartësi që varijon ndërmjet 1500 dhe 1800 metra mbi nivelin e detit. Sipërfaqja e zonës së parkut të erës është kryesisht e dominuar nga pyje dhe kullota malore që shtrihen mbi terrene shkëmbore. Largpërquesi buron nga nënstacioni i parkut të erës i vendosur në Bajgorë dhe lidhet me rrjetin kombëtar të distribucionit përmes nënstacionit në Vushtrri. Largpërquesi është 19,5 kilometra i gjatë dhe shtrihet në lartësi prej 528 deri në 1600 metra mbi nivelin e detit. Ajo përshkon fshatin e Bajgorës, Gumnishtës, Rashanit, Tërstenës, Pasomës, Sllatinës, Banjskës, Dobrollukës dhe Vushtrrisë. Rruga që përshkon largpërquesi është kryesisht në zona malore dhe kodrinore dhe në toka bujqësore në pjesën përfundimtare. Projekti shtrihet në sipërfaqe prej 80 kilometrash katrorë, që përfshinë: Infrastrukturën e parkut të erës, duke përfshirë themelet e turbinave dhe platformat, nënstacionin, platformat e përhershme të vinçit dhe rrugët e casjes;

		Udhëpërshkrimin e largpërquesit, duke përfshirë kullat dhe rrugët e casjes; dhe Zonën e sigurisë, duke përfshirë një zonë rrethuese prej 1 kilometri jashtë turbinave, ku nuk duhet ndërtuar shtëpitë. Turbinat e erës janë të lidhura mes vete me kablllo nëntokësore 33 kV (duke përfshirë edhe linjat e transferit të dhënave – kabllimi i brendshëm i parkut të erës), të cilat do të futen në kanal dhe do të groposen. Kycja në rrjetin e distribuimit të nivelit 110 kV do të bëhet përmes largpërquesit 110 kV, në nënstacionin e Vushtrrisë.			
2.2.	Numri kadastral i parcelës	Lista ngastrave kadastrale që janë marrë në shfrytëzim të projektit për turbinat nga 1-9			
		71208001-278-0	71208001-1209-0	71208001-863-0	71208001-294-0
		71208001-283-0	71208001-1210-0	71208001-858-0	71208001-290-0
		71208001-867-0	71208001-1206-0	71208001-857-0	71208001-291-0
		71208001-869-0	71208001-865-0	71208001-279-0	71208001-261-0
		71208001-851-0	71208001-860-0	71208001-2324-0	71208001-266-0
		71208001-856-2	71208001-861-0	71208001-280-0	71208001-265-0
		71208001-873-0	71208001-859-0	71208001-281-0	71208001-297-0
		71208001-302-0	71208001-94	71208001-76-0	71208001-71-0

		71208001-263-0	71208001-2341-0	71208001-67-0	71208001-72-0
		71208001-73-0	71208001-123-0	71208001-487-0	71208001-70-0
		71208001-264-0	71208001-120-0	71208001-66-0	71208065-1009-0
		71208001-85-0	71208001-89-0	71208001-2326-0	71208001-80-0
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objekteve dhe aktiviteteve të tyre në atë zonë	Parku i Energjisë me erë “Selaci 1” i kompanisë “Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë është ndërtuar në lokacionet e fshatit Selac, komuna e Mitrovicës. Jane ndërtuar gjithsejtë 9 turbina me erë të identifikuar me numra. Ngastrat e lartëcekura janë prona të marura nën qiramarrje për 99 vite ose të blera në emër të kompanisë “Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë, bazuar në dëshmitë e Çertifikatave të pronësisë nga të cilat jepen edhe këto të dhëna: lloji i shfrytëzimit të ngastrave –bujqësore, shfrytëzimi aktual i ngastrave - kullosa, klasa e kualitetit – kullosë e klasit të shtatë. Në hartën në vijim shihen lokacionet ku jane të vendosura turbinat me erë.			



		 Pamja e lokacionit me Google Earth
2.4.	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Llojet e identifikuara gjatë studimeve në literaturë dhe fushë përfshijnë: • 441specie të florës • 126 specie invertebrorë • 17 specie peshqish • 10 specie amfibe • 21 specie zvarranikësh • 116specie zogjësh; • 21 specie të lakuriqëve (16 të konfirmuara); 27 specie gjitarësh (përveq lakuriqëve).

	Studimet në terren identifikuan disa specie dhe habitate me shqetësim për ruajtjen e tyre, duke përfshirë speciet e habitatit kritik (CH) dhe karakteristikave prioritare të biodiversitetit (PBF). Për të zbutur ndikimet negative, u zhvilluan dhe u zbatuan plane menaxhimi, siç është Plani i Menaxhimit të Biodiversitetit (BMP). Veçanërisht, <i>Centaurea kotschyana</i> Heuff. dhe <i>Centaurea melanocephala</i> Pančić u regjistruan për herë të parë në zonë në fillim të shtatorit 2021. Për shumë PBF, CH dhe specie të tjera të rrezikuara, u aplikuan masa të tilla si demarkimi i habitatit, zhvendosja në vende më të sigurta dhe monitorimi i vazhdueshëm - një qasje e paprecedentë në Kosovë. Përveç kësaj, speciet e mbrojtura të kafshëve, duke përfshirë <i>Testudo hermanni</i> Gmelin, dhe fole të ndryshme të milingonave, u zhvendosën në habitate të paprekura për të minimizuar ndikimet e ndërtimit. Ndërsa për sa i përket monitorimit të faunës një program monitorimi tre-vjeçar (21 muaj të dhëna) u krye për të vlerësuar vdekjet e shpendëve dhe lakuriqëve të natës dhe modelet e aktivitetit sezonal. Kërkime sistematike të kufomave u kryen në secilën turbinë nga prilli deri në tetor, të viteve 2022 deri në 2024, dhe aktiviteti i lakuriqëve të natës u gjurmua duke përdorur detektorë akustikë të montuar në lartësinë e pacelës në shtatë grupe turbinash. U përfshinë prova të qëndrueshmërisë së kufomave dhe efikasitetit të kërkuesit, së bashku me të dhënat e motit dhe funksionimit të turbinës. Rezultatet treguan shkallë të ulëta deri të moderuara të vdekshmërisë, me lakuriqët e natës që përbënin shumicën e përplasjeve. Vdekshmëria arriti kulmin në fund të verës dhe në fillim të vjeshtës 2022-2024,
--	---

veçanërisht në shpejtësi të ulët të erës (~ 1.5 m/s) dhe temperatura më të larta ($>10^{\circ}\text{C}$), me aktivitet që bie mbi 7-8 m/s.

Këto gjetje nënvizojnë nevojën për zbutje të synuar, siç është kufizimi gjatë periudhave me rrezik të lartë. Në mungesë të pragjeve kombëtare të vdekshmërisë ose standardeve të mbrojtjes së jetës së egër, Bajgora ilustron se si menaxhimi adaptiv mund të përshtatë objektivat e energjisë së ripërtitshme me ruajtjen e biodiversitetit, duke vendosur një precedent për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë.

Gjatë monitorimit të zogjve dhe lakuriqave të natës janë marrë të gjitha masat e duhura në lidhje me Covid. Ekipi është siguruar që gjithmonë të mbaj dorëzat, maskat mbrojtëse si dhe është dezinfektuar hapësira e punës.



		 Fotografi gjatë monitorimit të zogjve dhe lakuriqeve të natës në fazën e operimit.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Lokacioni ku është ndertuar Parku i Energjisë me erë “Selaci 1” i kompanisë “Sowi Kosovo” L.L.C. nuk është e ndërtuar ne zone te veçant te Mbrojtur dhe nuk funksionon si korridor për zogjë.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË		
3.1.Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore		
3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Komponentët e Projektit janë si në vijim: • turbinat e erës (kulla, themelet, platforma dhe platformat e vinçit)); • rrugët ndihmëse; • nënstacioni;

	• largpërquesi; • kabllimi nëntokësor elektrik; dhe • zonat e deponimit. Informatat mbi komponentët e Projektit të Erës në Bajgorë, duke përfshirë edhe turbinat e erës, largpërquesin dhe pjesët ndihmës janë të paraqitura në pjesët në vijim. Turbinat e erës Parku i erës përbëhet nga 27 turbina të vendosura në tri zona të emëruara si Selac 1 (WTG 1-9), Selac 2 (WTG 10-18) dhe Selac 3 (WTG 19-27).
--	---

Përzgjedhja e llojit të turbinës së erës është bërë duke u bazuar në ofertat teknike dhe komerciale të gatshme në treg. Ofertat janë pranuar nga disa kompani prodhuese, duke përfshirë Vestas, GE, Senvion dhe Enercon. Si rezultat janë përzgjedhur turbinat e llojit GE 3.8 – 137.




Fig 1. Dimensionet e turbinës GE 3.8-137

Karakteristikat teknike të turbinave të erës janë si në vijim:

- gjatësia e përgjithshme: 178.5 m
- (1) gjatësia e trupit: 110 m

- (2) diametri i rotorit: 137 m
- kapaciteti: 3.83 megavat.

Distanca në mes turbinave ndryshon nga 375 deri në 980 metra. Duke marrë parasysh terrenin e papërshtatshëm, sektori i menaxhimit të shpejtësisë së erës dhe raporti i turbulencave i bërë nga GE kanë konfirmuar llojin më të përshtatshëm të turbinës. Themeli i turbinës zë një sipërfaqe prej 359,7 metrash katrorë dhe do të vendoset në thellësi prej 3,2 metrash; kanalet në të cilat do të vendosen kabllojt janë të vendosura në thellësi prej 0,80 metrash.



Nënstacioni i transformatorit

Për të siguruar transformimin e rrymës së prodhuar nga turbinat e erës, një nënstation i brendshëm transformatori 110/33 kV është ndërtuar.

	Nënstacioni i planifikuar është i vendosur në pjesën jugore të zonës së projektit, në mes të turbinës numër 2 dhe 3. Nënstacioni zë sipërfaqe prej 1260 m2 dhe përfshinë elementet si në vijim: • Kaldanë e jashtme 110 kV; • Transformatorin e fuqisë 33/110kV (i jashtëm); • Ndërtesën administrative me ndërpresin 33 kV, sallën e kontrollit dhe monitorimit, zyrën dhe objektin e menaxhimit, të furnizimit; dhe • Rrethojat, rrugët dhe vend - parkingjet. Të gjitha elementet janë vendosur në themel betoni të dizjnuar bazuar në kushtet e dheut dhe tokës në zonën e projektit. Kompleksi i nënstacionit të transformatorit është i rrethuar dhe i pajisur me sistem të jashtëm ndriqimi. Nënstacioni është i pajisur me dy transformatorë të fuqisë 50/63 MVA që rrisin fuqinë e prodhuar nga turbinat nga 33 kV në 110kV. Ndërlidhja në mes secilës turbinë dhe nënstacionit bëhet përmes një rrjeti të kablllove nëntokësore (33 kV). Ky rrjet është i vendosur kryesisht në afërsi të rrugëve ndihmëse të turbinave të erës. Kabllot janë vendosur në kanale të gërmuara anash rrugëve në thellësi prej 80 centimetrash; kabllot janë mbuluar me dhe.
--	---

Gjatësia e përafërt e kabllave për secilën komponentë të parkut të erës është:

Selac I – 5,500 m Selac II – 10,100 m Selac III – 20,500 m.



Pamja e Nënstacionit në Selac

Largpërquesi

Largpërquesi ndërlidhë nënstationin e parkut të erës në Bajgorë me nënstationin në Vushtri, që është pjesë e rrjetit kombëtar të distribuimit të operuar nga KOSTT.

Lëgpërquesi është rreth 19,5 kilometra i gjatë dhe përbëhet nga 92 kulla, nga të cilat 36 janë me kushineta dhe 56 të tipit këndor. Largpërquesi kalon edhe në mes të rrugës ekzistuese Vushtri – Mitrovicë (kulla nr. 11 – kulla nr. 12), në disa linja ekzistuese (të tensionit të ulët) dhe të linjës së transmisionit 10kV. Pjesa nga Kulla 1 deri në kullën 16 është në sipërfaqe të rrafshët. Nga kulla nr.

		16 deri tek kulla nr. 37 sipërfaqja është malore, me lugina të vogla dhe pjerrtësina të theksuara. Pjesa nga kulla nr. 37 deri tek kulla nr. 92 është e egër malore, me lugina të mëdha dhe të pjerrëta. Për të lehtësuar ndërtimin dhe mirëmbajtjen gjatë operimit, udha e largpërquesit është vendosur afër rrugëve ekzistuese: nga nënstacioni i Vushtrisë linja kalon përmes rrugës Vushtri – Mitrovicë, përmes një korridori të zbrazur, afër fshatit Sllatinë, në pjesën perëndimore të fshatit të Banjskës, Pasomës dhe Tërenit, vazhdon në pjesën lindore të fshatit Gumnishtë, afër fshatit Bajgore dhe vazhdon deri tek nënstacioni në parkun e erës.																				
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Aktivitetet gjatë fazës së ndërtimit janë zhvilluar vetëm gjatë orëve të ditës, ndërsa në fazën e operimit, orari i punës së punëtorëve është nga ora 08:00 deri në ora 16:00, nga e hëna deri të shtunën.																				
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	<table><tr><th>Informtata</th><th>Përshkrimi</th></tr><tr><td>Numri i turbinave</td><td>27</td></tr><tr><td>Lloji i turbinave</td><td>GE 3.8-137</td></tr><tr><td>Kapaciteti i turbinave</td><td>3.83 megavat</td></tr><tr><td>Kapaciteti i plotë i instaluar</td><td>103.41 megavat</td></tr><tr><td>Neto prodhimi vjetor i energjisë</td><td>Rreth 320 Gigavat/vit</td></tr><tr><td>Emri i largpërquesit</td><td>LP 110kV NS Vushtrria 1-NS PEE Selac</td></tr><tr><td>Lloji i largpërquesit</td><td>110kV linjë transmisioni me një qark të vetëm</td></tr><tr><td>Gjatësia e largpërquesit</td><td>Rreth 19.5 km</td></tr><tr><td>Kullat e largpërquesit</td><td>92</td></tr></table>	Informtata	Përshkrimi	Numri i turbinave	27	Lloji i turbinave	GE 3.8-137	Kapaciteti i turbinave	3.83 megavat	Kapaciteti i plotë i instaluar	103.41 megavat	Neto prodhimi vjetor i energjisë	Rreth 320 Gigavat/vit	Emri i largpërquesit	LP 110kV NS Vushtrria 1-NS PEE Selac	Lloji i largpërquesit	110kV linjë transmisioni me një qark të vetëm	Gjatësia e largpërquesit	Rreth 19.5 km	Kullat e largpërquesit	92
Informtata	Përshkrimi																					
Numri i turbinave	27																					
Lloji i turbinave	GE 3.8-137																					
Kapaciteti i turbinave	3.83 megavat																					
Kapaciteti i plotë i instaluar	103.41 megavat																					
Neto prodhimi vjetor i energjisë	Rreth 320 Gigavat/vit																					
Emri i largpërquesit	LP 110kV NS Vushtrria 1-NS PEE Selac																					
Lloji i largpërquesit	110kV linjë transmisioni me një qark të vetëm																					
Gjatësia e largpërquesit	Rreth 19.5 km																					
Kullat e largpërquesit	92																					

		Pika e kycjes	110kV nënstacioni Vushtrri (pika e kycjes në operatorin publik të rrjetit “KOSTT”)
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse.	Komponentët hyrëse gjatë aktiviteteve që zhvillohen në kompanisë ” Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë, Parku i energjisë me erë “Selaci 1” janë: • Karburantet djegëse të lëngëta (naftë dhe benzinë). Karburantet djegëse të lëngëta benzina dhe nafta shërbejnë për furnizimin e automjeteve, për nevoja të kompanisë.	
3.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Kompania ” Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë, Parku i energjisë me erë “Selaci 1” nuk posedon rezervuar për deponimin e lëndëve djegëse.	
3.1.7.	Lista e legjislacionit dhe udhëzimeve administrative në fuqi	➤ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 ➤ Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181 ➤ Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 ➤ Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110 ➤ Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26 ➤ Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 ➤ Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 ➤ Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11	

		➤ Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197 ➤ Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025 ➤ Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 ➤ Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 ➤ Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri Nr. 04/L-012 ➤ Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.
--	--	---

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Lokacioni ku gjendet Parku i Energjisë me erë “Selaci 1” i kompanisë “Sowi Kosovo” L.L.C. është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim: • Përmirësimin e vazhdueshëm i mjedisit Respektimin e legjislacionit vendor • Parandalimin e dëmtimit të mjedisit • Përmirësimin e komunikimit me autoritetet
3.2.2.	Raportimi	Kompania deri tash ka prodhuar raporte mujore të vlefshme për gjithë periudhën e ndërtimit dhe operimit, nga aspekti performances mjedisore dhe sociale të gjitha kërkesë edhe të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) si financuese kryesore e projektit.

4. AJRI

4.1.	Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse	Në fazën e ndërtimit: ❖ Emitimi i materieve të ndotura në ajër nga automjetet dhe mekanizmat ndërtimor
------	--	---

		❖ Pluhuri i cili ngritet gjatë punëve ndërtimore, pastrimeve, hapjen e kanaleve, shtruarjet me dhe të platove, rrugëve etj, ❖ Lëvizja e automjeteve dhe mekanizmave gjatë punës. Në fazën e operimit: ❖ Nuk parashihet të ketë pasi që do të ketë gjenerim të energjisë nga era.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Gjatë ndërtimit ndikimi i emisionit të materieve ndotëse në cilësinë e ajrit është varur para se gjithash nga kushtet klimatike –meteorologjike, numri i automjeteve të cilat kanë qarkulluar brenda dhe jashtë lokacionit të ndërtimit Grimcat e pluhurit janë emetohur në ajër, dhe pastaj për shkak të peshës së tyre kanë gravituar në tokë dhe kanë ndikuar në cilësinë e ajrit. Me fillimin e operimit dhe zvogëlimin e aktiviteteve në terren nuk pritet të ketë ndotje të mëtutjeshme bazuar edhe në principin e punës së impiantit.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Për shkak të natyrës së punëve dhe projektit, si dhe për shkak të mos-përdorimit të materieve të rrezikshme e rrjedhimisht as depozitimit të tyre nuk ka ndonjë mundësi të ardhjes deri te ndotja e burimeve difuzive.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Kompania “Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë, Parku i Energjisë me erë “Selaci 1” nuk ka Pajisjet

		për trajtimin e gazrave shkarkuese pasi që gjatë funksionimit kontinuel të projektit nuk kemi emitim të gazrave shkarkuese nga procesi teknologjik i perfitimit të Energjisë me erë.
4.5.	Pajisjet për de- pluhurin	Nuk aplikohet.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Parku i Energjisë me erë “Selaci 1” nuk bënë Monitorimin e emisioneve.
4.7.	Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ë ajrit	Parku i Energjisë me erë “Selaci 1” nuk bënë Monitorimin e emisioneve.
4.8.	Raportimet	Për shkak që aktiviteti nuk do të ketë gjenerim të emisioneve, nuk janë paraparë raportimet për këtë aktivitet.
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Sperkatja e pluhurit me uje gjate fazes se ndertimit nga levizja e makinerive.

5. UJI

5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Duke u nisur nga arsyja se turbinat me erë në përgjithësi nuk shfrytëzojnë ujin për funksionimin e tyre, atëherë nënkuptohet se edhe ky park i energjisë me erë që është ndërtuar nuk do të gjenerojë ujëra të ndotura. Gjatë ndërtimit të turbinave me erë është përgatitur një sipërfaqe në formë platoje ku janë vendosur makineritë punuese me të gjitha mekanizmat përcjellës, ku është penguar derdhja e vajrave apo karburanteve në rrjedhjet
------	-----------------------------------	--

		nëntokësore të ujërave. Secila platformë është pajisur me rrjet drenazhimi ku ujërat e rreshjeve do të kullohen. Duke qenë se gjatë mirëmbajtjes dhe servisimit të turbinave do të angazhohet kompania e cila edhe është furnitorja e turbinave pra kompania GE e cila është kompani ndërkombëtare me eksperiencë dhe standarde të larta mjedisore, i gjithë stafi i mirëmbajtjes është i trajnuar në parandalimin e rrjedhjeve aksidentale të vajrave.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Gjatë funksionimit të parkut me energji të erës “Selaci 1” nuk do të gjenerohen ujrat e ndotura.
5.3.	Ndikimet në ujë	Ndikimet në ujë nga aktiviteti i Kompanisë “Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë, Parku i Energjisë me erë “Selaci 1” mund të jenë nga derdhja aksidentale e derivateve si nafta, vajrat e ndryshme nga makinat për transportin e mullinjeve me ere. Rezervarët ku mbahen karburantet për automjetet dhe mekanizmat ndërtimor punues jenë të sigurt me enë të dyfishta ashtu që në asnjë mënyrë të mos vije deri derdhja e derivateve në tokë. Servisimi i automjeteve është bërë dhe vazhdon të bëhet në serviset e autorizuara për automjete, jashtë vend-punishtes. Vaji i makinave sic u cekë më lartë është ndërruar në serviset e autorizuara të kontraktorëve, jashtë vend-punishtes.

		Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në vend punishte për shkak të avarive në makinat e punës, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet. Në punishte gjatë gjithë kohës ka pasur material (pluhur druri) dhe pajisje profesionale për parandalimin e rrjedhjeve/shërndarjeve shih fig më poshtë që në raste të derdhjeve të vajrave të ndryshme të intervenohet me njëherë për pastrim. Mbeturinat e lëngta që janë krijuar nga ndërrimi i vajrave të pajimeve janë deponuar në enë të posaçme dhe i janë dhënë kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura. Depoja ku janë deponohuar derivatet, vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar ka qenë e paqasshme për persona të pa-autorizuar kurse platoja (dyshemeja) e betonuar. Për nevojat e personelit punues janë vendosur tualete të lidhura me gropë septike si dhe kabina lëvizëse të miërmbajtura nga kompania MSS në baza javore.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Nuk aplikohet
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Gjatë funksionimit të parkut me energji të erës “Selaci 1” nuk do të gjenerohen ujrat e ndotura andaj edhe nuk do të bëhet trajtim.

5.6.	Kontrolli dhe matjet	Nuk aplikohet
5.7.	Raportimi	Nuk aplikohet
5.8.	Leje ujqre pr shfrytëzim të ujit	Parku i Energjisë me erë “Selaci 1”, nuk posedon Leje Ujqre pr shfrytëzim dhe shkarkimin e ujërave të ndotura
5.9.	Leje ujqre shkarkimin e ujërave	Parku i Energjisë me erë “Selaci 1”, nuk posedon Leje Ujqre pr shfrytëzim dhe shkarkimin e ujërave të ndotura
5.10.	Masat pr zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Masa parandaluese pr mbrojtjen e ujit janë zbatuar në të gjithë zonën e projektit, duke përfshirë menaxhimin e derdhjeve, ruajtjen e sigurt të karburanteve/vajrave me përmbajtje sekondare, kontrollin e ujërave të shiut dhe masat kundër erozionit, si dhe menaxhimin e mbetjeve. Inspektimet periodike nuk kanë identifikuar shenja të ndotjes së ujit gjatë periudhës së raportimit.

6. ZHURMA

6.1.	Burimet	Me termin zhurmë nënkuptojmë çdo tingull niveli i të cilit nuk kalon vlerat e caktuara me ligj. Zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin e nervor, në hipertension, në koncentrimin e njeriut në punë etj. Zhurma krijohet nga automjetet transportuese, pajimeve gjatë funksionimit të parkut energjetik.
------	---------	--

		Matjet dhe modelimet e zhurmës të bëra nga kompania ndërkombëtare kanë treguar që gjatë operimit të turbinave nuk do të ketë emetim të zhurmës në nivele të pa-pranueshme gjithashtu duke pasur parasysh faktin që në afërsi të trubniave nuk ka vendbanime. Gjatë punës së parkut të energjisë me erë mbrojtja e mjedisit nga zhurma sigurohet me mirëmbajtjen e rregullt të turbinave.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Gjatë fazës së operimit janë bërë matje të zhurmës për të konstatuar që zhurma e gjeneruar nga turbinat nuk tejkalon nivelet e lejuar. Ky monitorim është bërë nga kompani private ndërkombëtare të cilën ka hartuar edhe raportin e matjes së zhurmës e cila përshkruan metodologjinë dhe rezultatete.
6.3.	Raportimet	Gjatë fazës së operimit janë bërë matje të zhurmës për të konstatuar që zhurma e gjeneruar nga turbinat nuk tejkalon nivelet e lejuar. Ky monitorim është bërë nga kompani private ndërkombëtare të cilën ka hartuar edhe raportin e matjes së zhurmës e cila përshkruan metodologjinë dhe rezultatete. Këto rezultate janë shpërndarë edhe me banorë të cilët gjenden afër parkut me erë.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Ndikimet në tokë nga dheu i gërmuar për vendosjen e një turbine (turbina me shtyllë) për sipërfaqen e themelit rrethor me diameter $D=19.5\text{m}$ dhe thellësi maksimale 2.75 m, është 821.281 m^3 kurse për 9 turbina është $7,391.529\text{ m}^3$. Sipas projektit ideor është përcaktuar saktësisht vendosja e 9 turbinave në lokacionin kodrinoro-fushor, ku gërmimet apo përdorimi i dheut për përgatitjen

	e rrugëve gjatë ndërtimit dhe përgatitjet e sipërfaqeve për vendosjen e makinerisë, pajisjeve dhe servisimi i tyre, nuk kemi një parallogari sepse vlera e dheut të gërmuar varet nga pozicioni i vendosjes së turbinave si dhe hapja e rrugëve për manipulim. Shtresa prej 50-100 cm e dheut të gërmuar nga përgatitja e bazës për vendosjen e turbinave është duke u përdorur si masë e dheut për mbulimin e bazës së betonuar në trashësi prej 50-100cm rrjedhimisht për kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme. Sasia e dheut e mbetur e deponuar sipas standardeve në deponi me autorizim mjedisor, do të rikultivohen. Mbeturinat Gjatë fazës së ndërtimit të parkut energjetik, do të krijohen mbeturina jo të rrezikshme nga materialet ndërtimore, ambalazhimet e ndryshme, mbeturinat komunale që është si pasojë e punimeve të zhvilluara dhe pranisë së personelit në punishten ndërtimore. Gjatë operimit nuk parashihet të ketë gjenerim të mbeturinave përveç atyre komunale që prap do të trajtohen konform marrëveshjes me kompaninë regjionale “Uniteti”. Derdhjet e pakontrolluara të derivateve dhe vajrave motorike Gjatë pranimiit dhe dërgimit të materialeve, ndërtimit dhe montimit, si dhe shfrytëzimit të automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimor mundë të vie deri te derdhjet e pakontrolluara të derivateve dhe vajrave motorike në tokë e pastaj edhe në ujërat nën tokësore.
--	---

		Këto derdhje mund të bëhen nga mos mirëmbajtja e rregullt e automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimor apo nga moskujdesi i faktorit njeri.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Rezervarët ku mbahen karburantet për automjetet dhe mekanizmat ndërtimor janë të sigurt dhe të vendosura në enë të dyfishta ashtu që në asnjë mënyrë të mos vie deri derdhja e derivateve në tokë. Servisimi i automjeteve bëhet jashtë punishtes dhe nga servise të autorizuar. Ndërrimi i vajit të makinave, është bërë në servise të autorizuar dhe jashtë vend-punishtes. Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në vend punishte për shkak të avarive në makinat e punës, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet. Në punishte gjatë gjithë kohës ka pasur material (pluhur druri) dhe pajisje profesionale për parandalimin e rrjedhjeve/shërndarjeve që në raste të derdhjeve të vajrave të ndryshme të intervenohet me njëherë për pastrim. Mbeturinat e lëngta që janë krijuar nga ndërrimi i vajrave të pajimeve janë deponuar në enë të posaçme dhe i janë dhënë kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura. Depoja ku janë deponohuar derivatet, vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar ka qenë e paqasshme për persona të pa-autorizuar kurse platoja (dysHEMEJA) e betonuar.

		Për nevojat e personelit punues janë vendosur tualete të lidhura me gropë septike si dhe kabina lëvizëse të miërmajtura nga kompania MSS në baza javore.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Gjatë fazave të projektit është hartuar nje plan rehabilitimi dhe rivegjetimi per zonat te cilat jane prekur nga projekti dhe jane paraparë te rehabilitohen. Ky plan është implementuar pas përfundimit të ndërtimit, pra gjatë fazës së operimit. Plani është dorëzuar edhe tek autoritete kompetente ne MMPHI.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave			
		Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë
			Letra	Jo të rrezikshme
		17 02 03	Plastika	Jo të rrezikshme
		15 01 01 20 01 01 20 01 08	Mbeturinat e ngurta komunale	Jo te rrezikshme
8.2.	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Nuk bëhet magazinimi i përkohshëm i mbeturinave, por mbeturinat të ngurta komunale, vendosen në kontejnerë për mbeturina të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.		

8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Gjatë fazës së operimit, nuk ka gjenerim të mbeturinave. Secili kontraktor është i detyruar të mirembaje vendin e punës gjatë kohës sa janë në hapësirat e projektit. Menaxhimi i mbeturinave nga vizitorët bëhet nga kompania e cila është e kontraktuar për mirëmbajtje të hapësirave të projektit.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër- kontratë me kompaninë me leje përkatëse	Nuk aplikohet
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Nuk aplikohet
8.6.	Raportimi	Nuk aplikohet
9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Kompania “Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë ka hartuar Planin për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Meqenëse kemi të bëjmë me Kompaninë “Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë ku si aktivitet ka prodhimin e energjisë elektrike me urre ku nuk kemi deponimin dhe distribuimin e karburanteve të lëngët nga edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale. Rreziku mund të vije nga nga derdhjet jo të kontrolluara apo aksidentale të vajrave nga pelcitja e gypave hidraolike të automjeteve transportuese por sic u cekë më sipër mirëmbajtjen e turbinave e bënë vetë kompania prodhuese GE e

		cila ka përvojë shumë vjeçare si në menaxhim mjedisor ashtu edhe në parandalimin e rasteve aksidentale. Sa i përket zjarrit mundë të konstatojmë se realisht është e mundur por nuk do të bëjmë ndonjë analizë detale mbi vlerësimin e rrezikut nga zjarri. Kompania ne raste te ndonje zjarri do ti merrre të gjitha masat preventive që duhet të ndermirën gjatë një aksidenti nga zjarri. Kompania ka siguruar paisjet kunder zjarrit.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave gjatë funksionimit të turbinave me erë ku mund të vjen nëse këputet ndonjë lopatëz e fluturakes, rrëzohet shtylla e turbinës me erë, vjen deri te rrjedhja e vajit, goditja e rrufesë dhe krijimi i zjarrit. Kompania sipas projektit te ndertimit çdo turbinë me erë e ka vendosur në distancë të caktuar nga objektet e banimit dhe nga turbinat tjera ashtu që të bëhen llogaritjet statike dhe gjeo-mekanike në përgatitjen e bazamentit për përforcimin e turbinave me erë si dhe është i vendosur rrufepritësi për çdo turbinë me erë.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Nuk aplikohet
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Kompania “Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë nuk ka hartuar ndonje plan për mbrojtjen nga zjarri në anën tjetër secila turbinë ka te vendosur sistemin e rrufepritësit dhe te tokëzimit te cilët kompania i mirëmbanë dhe i teston, si dhe të gjithë kontraktorët kanë staf të trajnuar dhe certifikuar për përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit dhe si të reagojnë në rast të zjarrit.
10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Kompania “Sowi Kosovo” L.L.C. Prishtinë ne rast te paraqitjes se ndonje avarie ose keqfunksionim do të ndërpritet puna.
10.2.	Ndërprerja e punës	Secila turbinë është e pajisur me sistem frenimi, në rast të erës së madhe apo ndonjë avarie dhe duke qenë se turbinat nuk janë të lidhura njëra me tjetren pra funksionojnë në mënyre autonome, edhe ndërprerja e punës së tyre në raste jo-stabile të punës është më e lehtë dhe kontrollohet përmes sistemeve kompjuterike.
11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT		
Gjatë funksionimit kontinuel të parkut me erë “Selaci 1”, ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është i pa përfillshëm.		

Personi përgjegjës për mjedis

Hana Zeka

Nënshkrimi



Personi përgjegjës i kompanisë

Domenico Catalano

Nënshkrimi

